



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 7 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Parashtrime mbi Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit të Nasim Haradinajt

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Karl Bakli

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Nasim Haradinajt ("z. Haradinaj"). Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi z. Haradinaj të dorëzonte parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të martën, 1 qershor 2021, dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") do të dorëzonte parashtrime më pas. ("ZPS").² Megjithatë, Z. Haradinaj deri tani nuk ka dorëzuar asnjë parashtrim.

II. DIPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE DHE DISKUTIMI

2. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se, në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të shqyrtojë nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim të z. Haradinaj pasi të kenë kaluar (2) muaj nga vendimi i lartpërmendur i 23 prillit 2021.

3. Në këtë drejtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se paraburgimi shqyrtohet automatikisht çdo dy muaj në bazë të nenit 41(10) të Ligjit.³ Gjithashtu, ZPS-ja ka detyrimin të dëshmojë se paraburgimi i z. Haradinaj është i domosdoshëm.

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik. Përpara këtij vendimi, Kryetarja kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatës të Vetëm; shih *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00189/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 prill 2021, publik, para. 39.

³ KSC-CC-PR-2020-09, F00006, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, publik, para. 68.

⁴ Për më tepër, nuk është detyra e z. Haradinaj që të dëshmojë ekzistencën e arsyeve që përlligjin lirimin e tij.⁵

4. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, urdhëron ZPS-në të dorëzojë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm për paraburgimin e z. Haradinaj, me mundësinë që z. Haradinaj të dorëzojë parashtrimet e veta.

III. VENDIM

5. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Haradinaj deri të **premtën, 11 qershor 2021**; dhe
- b. **URDHËRON** z. Haradinaj të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të tij, në qoftë se dëshiron, deri të **enjtën, 17 qershor 2021**.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

⁴ KSC-BC-2020-06, IA004, F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 17; KSC-BC-2020-06, IA001, F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, para. 14 ; KSC-BC-2020-06, IA003, F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 37; KSC-BC-2020-06, IA002, F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 23. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07, F00144, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 24 shkurt 2021, publik, para. 16.

⁵ Shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Gjykata Kushtetuese e Dhomave të Specializuara, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores dhe Procedurës së Provave të Miratuara nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomiës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 26 prill 2017, publik, para. 115.

E hënë, 7 qershor 2021

Në Hagë, Holandë